



UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI JURIDIK

Programi: E Drejta Civile dhe Pronësore

ABSTRAKTI

Tema e punimit të diplomës - studime post-diplomike Master: *Shqyrtimi i pasurisë trashëgimore nga noteri; Sfidat e noterit në zbatimin e LPJK-së*

Shqyrtimi i pasurisë trashëgimore nga noteri është një procedurë juridike e rëndësishme që përfshin verifikimin, vlerësimin dhe ndarjen e pasurisë së një trashëgimlënësit. Në këtë proces, është e rëndësishme të ketë njohuri të lartë të ligjeve të aplikueshme dhe të kryhet me saktësi dhe pa gabime. Procedura është shumë komplekse dhe kërkon profesionalizëm dhe përkushtim nga ana e noterit për të siguruar një zgjidhje të drejtë për të gjithë personat e interesuar.

Noteri është një profesionist dhe bënë zbatimin e drejtpërdrejt të ligjit, i cili ka përgjegjësi të rëndësishme për të shqyrtuar procedurën jokontestimore, pas shqyrtimit të vendosë mbi ndarjen e pasurisë së trashëgimlënësit, ku bëhet transferimi i pasurisë në mënyrë të ligjshme për të evidentuar të metat në të ardhmen. Po ashtu, në këtë proces, transparenca dhe integriteti i noterit janë thelbësor, si dhe përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për të lehtësuar dhe përmirësuar procesin, është më se i nevojshëm.

Në këtë punim, fillimisht janë prezantuar informacione mbi historikun e noterisë, pastaj janë diskutuar përgjegjësitë e noterit, procedura e vlerësimit të pasurisë dhe sfidat që mund të hasë noteri gjatë zbatimit të Ligjit për Procedurën Jokontestimore. Për të bërë një pasqyrim më të detajuar të këtyre procedurave, janë krahasuar disa nga praktikat dhe ligjet e vendeve të rajonit si të Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut dhe Rregullorja Nr. 650/2012 mbi juridiksionin, ligjin e

zbatueshëm, njohjen dhe zbatimin e vendimeve, pranimin dhe zbatimin e instrumenteve autentike në çështjet e trashëgimisë dhe në krijimin e një Certificate Evropiane të Trashëgimisë, duke marrë parasysh kompleksitetin dhe rëndësinë e tyre.

Në hulumtimin e bërë, u konkludua se fillimi i shqyrtimit të pasurisë trashëgimore nga noteri në Kosovë, megjithatë sfidat që mund të hasë, ka pasur një ndikim pozitiv dhe ka treguar efektivitet në zgjidhjen e çështjeve brenda një periudhe kohore relativisht të shkurtër.

Fjalë kyçe: Noteri, shqyrtimi i pasurisë trashëgimore, sfidat e noterit në zbatimin e LPJK-së, procedura jokontestimore, krahasimi me vendet e rajonit.

Kandidatja:

Albina Bejiqi

Mentor:

Prof.Ass.Dr. Bashkim Preteni